



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PORTUAL DURRËS  
DIVIZIONI JURIDIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2021

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data \_\_.04.2021]

Për: Shoqëritë BOE: **“CAUSHI M” shpk**, me adresë: Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-re, Zona Kadastrale 1090, Ballsh. Fier.

**“K.M.K” shpk** me adresë: Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-re, Zona Kadastrale 1090, Ballsh. Fier.

Procedura e prokurimit: “Procedure e hapur” (Prokurim me mjete elektronike).

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-83395-12-29-2020.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Zbatimi i projektit te kontrollit fizik te mjeteve ne Terminalin e Trageteve”**, me kohëzgjatje **120 ditë** nga data e njoftimit të fillimit të punimeve.

Buletini i Njoftimeve Publike: 31.12.2020, Nr. 131.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Operatori ekonomik **“BE-IS” sh.p.k me Nipt – K71412003A;**  
Oferta, në vlerën 13.866.467 (trembëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa tvsh.
2. Operatorët ekonomikë **“CAUSHI M” sh.p.k me Nipt – L884198010 & “K.M.K” sh.p.k me Nipt – L78223801E**  
Oferta, në vlerën 12.916.103 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëmbdhjetë mijë e njëqind e tre) lekë, pa tvsh.
3. Operatori ekonomik, **“KLAJGER KONSTRUKSION” sh.p.k me Nipt – K51423028P;**  
Oferta, në vlerën 14.367.921 (katëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë, pa tvsh.

4. Operatori ekonomik, **“LLAZO” sh.p.k me Nipt – K24218401K;**

Oferta, në vlerën 14.216.942,25 (katëmbëdhjetë milion e dyqind e gjashtëmbdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e dy presje njëzet e pesë) lekë, pa tvsh.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorët ekonomikë **“CAUSHI M” sh.p.k & “K.M.K” sh.pk**, perfaqesuar nga **“CAUSHI M” shpk**, me adresë: Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati I-re, Zona Kadastrale 1090, Ballsh. Fier, me ofertën me vlerë 12.916.103 (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëmbdhjetë mijë e njëqind e tre) lekë, pa tvsh, se është identifikuar si **oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Portual Durrës, me adresë: *“Lagjja nr. 1, Rruga Tregtare”*, Durrës, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do te veprohet sipas parashikimeve të nenit 58, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit përfundimtar pas procesit të rivlerësimit nga KVO është bërë në datën 16.03.2021.

**Ankesa:**

Shoqëria **“CAUSHI M” shpk** ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor formularin e ankesës, protokolluar në Autoritetin Portual Durrës me nr. 582 prot., datë 22.02.2021.

Shoqëria **“LLAZO” shpk** ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor formularin e ankesës, protokolluar në Autoritetin Portual Durrës me nr. 585 prot., datë 22.02.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhërin e Brëndëshëm për Pezullimin e Procedurës dhe ngritjen e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesës nr. 628 prot., date 24.02.2021, bazuar në Ligjin nr. 9463 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, dhe në Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, të ndryshuar.

Me shkresën nr. 582/1 prot., datë 03.03.2021, i është kthyer përgjigje shoqërisë **“CAUSHI M” shpk**, për vendimin e marrë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

Me shkresën nr. 726/1 prot., datë 02.03.2021, i është kthyer përgjigje shoqërisë **“LLAZO” shpk**, për vendimin e marrë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

Autoriteti Kontraktor zbatoi vendimin e Komisionit Shqyrtimit të Ankesës dhe kualifikojë operatorin ekonomik **“ CAUSHI M ” shpk**.

Pas këtij vendimi shoqëria **“BE-IS” shpk** ka paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor formularin e ankesës, protokolluar në Autoritetin Portual Durrës me nr. 966 prot., datë 23.03.2021.

Me shkresën nr. 966/1 prot., datë 30.03.2021, i është kthyer përgjigje shoqërisë **“BE-IS” shpk**, për vendimin e marrë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Pirro Vengu**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**DREJTOR I DIVIZIONIT JURIDIK**

**Aleks Marku**